

20110471309

**L I G J**  
**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTESIMIN**  
**E LIGJIT PËR VEPRIMTARI TURISTIKE**

Neni 1

Me Ligjin për veprimtari turistike ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numer 62/2004, 89/2008, 12/2009 dhe 17/11), neni 7-a ndryshohet si vijon:

"Në procedurën e mbikeqyrjes inspektuese zbatohen dispozitat e Ligjit për mbikeqyrje inspektuese dhe Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut, nëse me këto ligj nuk është rregulluar ndryshe."

Neni 2

Në nenin 65 paragrafi (2) ndryshohet si vijon:

"Kunder aktvendimit të inspektorit shtetëror të tregut mund të parashtrohet ankese në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin për Ankesa të formuar sipas Ligjit për Inspektoratin Shtetëror të Tregut."

Pas paragrafit 2 shtohet paragrafi i ri 3, si vijon:

"Kunder aktvendimit të inspektorit të autorizuar të komunes, perkatesisht të Qytetit të Shkupit mund të parashtrohet ankese në afat prej tete ditësh nga dita e pranimit të aktvendimit në Komisionin për Ankesa, të perbere prej tre anetareve, të formuar nga kryetari i komunes, perkatesisht i Qytetit të Shkupit, me ç'rast kryetari i Komisionit duhet të jete nga radhet e nepunesve udheheqes shtetërore, që nuk është përfshirë në kryerjen e mbikeqyrjes inspektuese."

Paragrafi 3 behet paragraf 4.

Neni 3

Neni 68 paragrafi 1 në fjalinë hyrëse shuma "1000 " zëvendësohen me shumën "800".

Në paragrafin 2 shuma "200" zëvendësohen me shumën "100".

Në paragrafin 3 shuma "300" zëvendësohen me shumën "200".

Neni 4

Pas nenit 68 shtohet neni i ri 68-a, si vijon:

"Neni 68-a

Gjore në shumë prej 1000 eurosh në kundërvlerë me denare do t'i kumtohet personit juridik, për veprime nga neni 68 paragrafi 1 i këtij ligji.

Gjore në shumë prej 200 eurosh në kundërvlerë me denare do t'i kumtohet edhe personit përgjegjës në personin juridik për veprime nga neni 68 paragrafi 1 i këtij ligji.

Gjore në shumë prej 300 eurosh në kundërvlerë me denare do t'i kumtohet tregtarit individual për veprime nga neni 68 paragrafi 1 i këtij ligji.

Gjore nga paragrafet 1, 2 dhe 3 të këtij neni paguhet në rastet kur kryeresi i kundërvajtjes të cilit aty për aty i është dhënë ftesë për pagesë të gjores, në afat prej tete ditësh nuk e paguan gjoren e kumtuar nga neni 68 i këtij ligji."

Neni 5

Procedurë kundërvajtëse për kundërvajtje të parapara me këto ligj, nuk mund të ngritet as të mbahet nëse kalojnë 18 muaj nga dita kur është kryer kundërvajtja.

Neni 6

Dispozitat e neneve 1 dhe 2 të ketij ligji do të fillojne të zbatohen me fillimin e zbatimit të Ligjit për mbikeqyrje inspektuese.

Neni 7

Autorizohet Komisioni Juridiko-Ligjvenes i Kuvendit të Republikës së Maqedonisë që të percaktoje tekst të spastruar të Ligjit për veprimtari turistike.

Neni 8

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e tete nga dita e botimit në "Gazeten Zyrtare të Republikës së Maqedonisë".